

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I MJEKËSISË

UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I MJEKËSISË PRISHTINË			
Pranuar me dt. 15/07/2026			
Njësia org.	Num. d.	Num. d. regjist.	Vlera
	12471		

RAPORT I KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

lidhur me konkursin për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës (PhD), në Fakultetin e Mjekësisë, për vitin akademik 2026/2027.

Bazuar në nenin 56 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë, në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2026, me Vendimin nr. Prot. 11931, datë 19.06.2026, ka emëruar Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me provimin pranues për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës (PhD) për vitin akademik 2026/2027, në këtë përbërje:

1. Prof. Dr. Mentor Sopjani – kryetar;
2. Prof. Ass. Valbona Govori – anëtare;
3. Ass. Arbnore Ibrahimaj-Gashi – anëtare.

Komisioni, në përbërjen e sipërshënuar, më datë 13 dhe 15 korrik 2026, ka mbajtur mbledhjen për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve të paraqitura në afatin ligjor, lidhur me rezultatet e konkursit publik për pranimin në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027.

Mbledhja është zhvilluar në prani dhe me asistimin administrativ të zyrtares së Fakultetit të Mjekësisë, znj. Ajtene Daci-Karabegleri.

Komisionit i janë vënë në dispozicion materialet relevante përkatëse, përfshirë dosjet e kandidatëve me ankesa, ankesat e paraqitura, dokumentacioni i konkursit publik nr. Prot. 1/345, datë 07.05.2026 dhe Rregulloren (nr. 1/147, datë 16.04.2026) aktuale për shqyrtimin e secilit rast.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe analizimit të secilës ankesë individualisht, Komisioni paraqet këto konstatime:

1. **Haki Selaj**: Aplikant në programin Mjekësi Klinike, ka paraqitur ankesë me nr. Prot. 12447, datë 08.07.2026, lidhur me mosvlerësimin e pikëve të konceptit ideor. Komisioni konstatoi se ankesa është e bazuar. Kjo është konfirmuar edhe nga Komisioni Vlerësues përmes shkresës nr. Prot. 12449, datë 09.07.2026, me të cilën pranohet se ka ndodhur një lëshim teknik gjatë procesit të vlerësimit.

Rrjedhimisht, kandidatit Haki Selaj i njihen edhe 40 pikë për konceptin ideor.

2. **Njomza Uka**: Aplikante në programin Mjekësi Klinike, ka paraqitur ankesë me nr. Prot. 12472, datë 10.07.2026, lidhur me mosvlerësimin e një prezantimi shkencor, të cilin kandidatja pretendon me ankesë se ka qenë prezantim oral në një konferencë kombëtare. Komisioni ri-shqyrtoi dokumentacionin e bashkëngjitur në dosjen e aplikimit, përkatësisht certifikatën e pjesëmarrjes dhe agjendën zyrtare të konferencës. Nga shqyrtimi i agjendës rezulton se kandidatja figuron në kategorinë e prezantimeve poster dhe jo në kategorinë e prezantimeve orale, siç pretendohet në ankesë. Komisioni bazohet në dokumentacionin zyrtar të lëshuar nga organizatori i konferencës, i cili përbën provën autentike për mënyrën e pjesëmarrjes së kandidatit në aktivitetin shkencor. Për rrjedhojë, pjesëmarrja e kandidates si prezantuese e

posterit në një konferencë kombëtare nuk plotëson kriteret për vlerësim me pikë, sipas nenit 10.5.3.8 të Rregullores nr. 1/147, datë 16.04.2026, respektivisht nenit 7.7.3.8 të Konkursit publik nr. 1/345, datë 07.05.2026.

Rrjedhimisht, Komisioni vlerëson se ankesa është e pabazuar dhe propozon refuzimin e saj.

3. Ilirian Lenjani: Aplikant në programin Stomatologji, ka paraqitur ankesë me nr. Prot. 12445, datë 09.07.2026, lidhur me: (1) mosvlerësimin e pjesëmarrjes në konferenca shkencore; (2) vlerësimin e testit "Analizë vlerësuese kritike e një artikulli shkencor".

a) Pjesëmarrja në konferenca shkencore. Në prani të kandidatit, Komisioni konstatoi se dosja e aplikimit nuk përmbante dokumentacion të plotë për konferencat shkencore, pasi certifikatat e dorëzuara nuk përmbanin të dhëna lidhur me: prezantimin ose jo të punimit; titullin e punimit; autorësinë/bashkautorësinë; formën e prezantimit (oral ose poster); elemente të tjera të nevojshme për vlerësim nga komisioni vlerësues. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në afatin e konkursit, Komisioni Vlerësues e kishte vlerësuar kandidatin me 8 nga 10 pikët maksimale të kësaj kategorie. Dokumentacioni shtesë është paraqitur vetëm së bashku me ankesën. Për këtë çështje, Komisioni kërkoi interpretim juridik nga Sekretari i Fakultetit të Mjekësisë, z. Visar Muqaj, sipas të cilit dokumentacioni i paplotë i dosjes së aplikimit nuk mund të plotësohet pas përfundimit të afatit të konkursit përmes procedurës së ankesës. Për më tepër, edhe në rast se kandidatit do t'i njiheshin maksimalisht edhe dy pikët e mbetura nga punimet/prezantimet, ai nuk do të arrinte pragun e nevojshëm për pranim krahasuar me kandidatin e fundit të pranuar. (2) Testi "Analizë vlerësuese kritike e një artikulli shkencor". Komisioni ia prezantoi kandidatit testin dhe mënyrën e vlerësimit. Komisioni vlerëson se nuk ka kompetencë ligjore për rivlerësimin profesional të testit gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesave, pasi kjo kompetencë i takon Komisionit Vlerësues.

Rrjedhimisht, ankesa e kandidatit refuzohet si e pabazuar.

4. Emira Lleshi: Aplikante në programin Mjekësi Klinike, ka paraqitur ankesë me nr. Prot. 12450, datë 09.07.2026, lidhur me pikët e fituara në testin "Analizë vlerësuese kritike e një artikulli shkencor", duke kërkuar qasje në test dhe në çelësin e vlerësimit. Komisioni i ankesave ia mundësoi kandidates qasjen në testin dhe çelësin përkatës. Pas shqyrtimit të tyre, kandidatja pranoi gjendjen faktike.

Komisioni konstatoi se ankesa është e pabazuar.

5. Dhurata Sylja: Aplikante në programin Stomatologji, ka paraqitur ankesë me nr. Prot. 12488, datë 10.07.2026, lidhur me: (1) notën mesatare; (2) mosvlerësimin e një punimi shkencor. Komisioni konstatoi se lidhur me notën mesatare ankesa është e bazuar. Nota mesatare e saktë është 8.27, përkatësisht 24.81 pikë, dhe jo 8.25, përkatësisht 24.75 pikë, siç ishte llogaritur fillimisht.

Sa i përket punimit shkencor, Komisioni konstatoi se punimi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në Rregulloren nr. 1/147, datë 16.04.2026 dhe në Konkursin publik (neni 8), pasi nuk është i fushës përkatëse dhe është botuar në një revistë që nuk plotëson kriteret e përcaktuara.

Prandaj, ankesa pranohet pjesërisht.

6. Yllka Begolli: Aplikante në programin Paraklinikë, ka paraqitur ankesë me nr. Prot. 12458, datë 09.07.2026, lidhur me: (1) mosvlerësimin e gjuhës angleze; (2) njoftimin e vonshëm për intervistë. Komisioni konstatoi se kandidatja nuk kishte dorëzuar dëshminë e njohjes së

gjuhës angleze të kërkuar sipas Rregullores nr. 1/147, datë 16.04.2026 (neni 10.8), respektivisht Konkursit publik (neni 10), e cila përbën kusht për vlerësim. Gjithashtu, kandidatja nuk kishte marrë pjesë në intervistë, me pasojat përkatëse. Sa i përket pretendimit për njoftim të vonshëm, Komisioni i ankesave nuk gjeti dispozitë ligjore që përcakton afat minimal për njoftimin e kandidatëve. Megjithatë, Komisioni rekomandon që në procedurat e ardhshme kandidatët të njoftohen sa më herët që të jetë e mundur.

Rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar.

7. Nart Ajeti: Aplikant në programin Stomatologji, ka paraqitur ankesë me nr. Prot. 12471, datë 10.07.2026, lidhur me (1) mosvlerësimin e gjuhës angleze dhe (2) njoftimin për intervistë. Komisioni konstatoi se rrethanat faktike dhe juridike janë të ngjashme me rastin e aplikantes Yllka Begolli. Përkatësisht, aplikanti nuk kishte dorëzuar dëshminë e njohjes së gjuhës angleze të kërkuar sipas Rregullores nr. 1/147, datë 16.04.2026 (neni 10.8), respektivisht Konkursit publik (neni 10), e cila përbën kusht për vlerësim. Gjithashtu, nuk kishte marrë pjesë në intervistë.

Për rrjedhojë, ankesa refuzohet si e pabazuar.

8. Doruntina Ukmata: Aplikante në programin Mjekësi Klinike, ka paraqitur ankesë me nr. Prot. 12469, datë 10.07.2026, lidhur me mosvlerësimin e një punimi të botuar në revistën "Mjeku". Komisioni konstatoi se pretendimet e kandidates bien në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Rregulloren nr. 1/147, datë 16.04.2026, neni 10.5.3.5, respektivisht Konkursin publik, neni 7.3.5.

Rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar.

PËRFUNDIM

Pas shqyrtimit të të gjitha ankesave dhe dokumentacionit përkatës, Komisioni konstaton se janë evidentuar vetëm disa lëshime teknike dhe materiale, të cilat duhet të korrigjohen përmes përditësimit të poentimit të kandidatëve përkatës, në përputhje me dispozitat e konkursit dhe rregullores në fuqi.

Për të gjitha rastet e tjera, Komisioni vlerëson se procedura e vlerësimit është zhvilluar në përputhje me aktet normative në fuqi dhe propozon që ankesat e pambështetura të refuzohen.

Prishtinë, më 15.07.2026.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave:

Prof. Dr. Mentor Sopjani, kryetar

Prof. Ass. Valbona Govori, anëtare

Ass. Arbnore Ibrahimaj-Gashi, anëtare

